# DËSHMI ARKIVI

**A-470188**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Muriqi ngjitet në mesin e golashënuesve më të mirë të Ligës së Kombeve, lë pas yje të mëdhenj |
| ADRESA | `https://piranjat.al/sport/muriqi-ngjitet-ne-mesin-e-golashenuesve-me-te-mire-te-liges-se-kombeve-le--i106118` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 20:00:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 19:56:02 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `83cd8f527f43914a1c9ac8e9d59abf69f4c28b728eb3ec8bab4f64946fe046f4` |
| TEKSTI | `cee4bf9ebccb6b5b0844e9b613851f59b44ac8acfd24fd36b50915b1209e158e` |
| PAMJA | `9f00d5517680fb11dec1f2ec7c77aff8c5ca0f2e20ce7cf69542026cf5352647` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0fb88baf869165cb53e3001ce67766bd331bdfa29f78c3eddef364c3c44b838f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0fb88baf869165cb53e3001ce67766bd331bdfa29f78c3eddef364c3c44b838f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# Muriqi ngjitet në mesin e golashënuesve më të mirë të Ligës së Kombeve, lë pas yje të mëdhenj

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 21:56



Sulmuesi dhe kapiteni i Kosovës, Vedat Muriqi, vazhdon të shkruajë emrin e tij në historinë e Ligës së Kombeve, duke u renditur në mesin e golashënuesve më të mirë të kësaj gare.

Sipas të dhënave të publikuara nga UEFA, Muriqi ka realizuar 14 gola në Ligën e Kombeve, duke u renditur në vendin e katërt në listën e golashënuesve më të mirë në histori të kësaj gare.

Para tij ndodhen vetëm Erling Haaland me 21 gola, ndërsa Aleksandar Mitrovic dhe Cristiano Ronaldo kanë nga 15 gola.

Me 14 realizime, Muriqi ka lënë pas disa prej emrave më të njohur të futbollit evropian, përfshirë Romelu Lukakun, Edin Dzekon, Kylian Mbappen dhe Viktor Gyokeres.

Ky rekord e vendos kapitenin e Kosovës në një shoqëri të veçantë, pasi vetëm tre futbollistë kanë shënuar më shumë gola se ai në historinë e Ligës së Kombeve.

Por, statistikat e Kosovës në këtë garë nuk ndalen vetëm te Muriqi.

"Dardanët" janë njëra prej përfaqësueseve që kanë dy futbollistë me nga një het-trik në historinë e Ligës së Kombeve.

Muriqi e realizoi het-trikun e tij më 23 mars 2025 ndaj Islandës, ndërsa Arbër Zeneli kishte shënuar tri gola në një ndeshje ndaj Azerbajxhanit më 20 nëntor 2018.

Kështu, Kosova ka dy futbollistë që kanë arritur të shënojnë nga tri gola në një ndeshje të Ligës së Kombeve, ndërsa Muriqi tashmë është vetëm një gol larg vendit të dytë në listën e golashënuesve më të mirë të kësaj gare.

## Artikuj te sugjeruar

SPORT 25 Shtator19:32

**"Dua të jem bodibilder deri sa të vdes"/ Japonezi 90-vjeçar stërvitet gjashtë ditë në javë dhe vazhdon të fitojë tituj**

Në moshën 90-vjeçare, Toshisuke Kanazawa vazhdon të ngrejë pesha, të marrë pjesë në gara dhe të fitojë ...

SPORT 25 Shtator19:27

**Skandali i falsifikimeve prek një tjetër lojtar të Zvicrës, pas Xhakës edhe Embolo jashtë ekipit për mashtrim**

Skandali i certifikatave të rreme të vaksinimit trondit sërish Kombëtaren e Zvicrës, teksa pas Granit Xhakës, një tjetër...

SPORT 25 Shtator18:55

**Kombëtarja mbyll përgatitjet për ndeshjen ndaj Bjellorusisë, mungon një nga lojtarët**

Kombëtarja shqiptare do të zbresë nesër në fushë për të nisur rrugëtimin në UEFA Nations League, me ndeshjen e...

SPORT 25 Shtator18:24

**"Hiqni sytë nga Broja", ish-mbrojtësi i kombëtares: E kemi pritur për 4 vite, duhet të kërkonim një talent si Gruda**

Ish-mbrojtësi i Kombëtares shqiptare, Kreshnik Çipi, ka bërë një deklaratë të fortë në lidhje me Armando Bro...

SPORT 25 Shtator15:52

**Alcaraz kërkon ndryshime! Tenisti kundër fundit të ndeshjeve të pas mesnate në Grand Slam**

Carlos Alcaraz kërkon ndryshime në programin e turneve Grand Slam, pas përfundimit të vonë të ndeshjeve në US Open. Spanjol...

SPORT 25 Shtator15:47

**Bjellorusia, testi zyrtar për trajnerin Maran: Shqipëria më emocionon dhe më bën krenar**

Në konferencën për shtyp, Maran pritet të zbulojë më shumë për mënyrën se si do ta ndërtojë skuadr...

SPORT 25 Shtator15:40

**Havertz dhe Musiala largohen nga grumbullimi i Gjermanisë, Klopp thërret Wirtz**

Kombëtarja e Gjermanisë ka pësuar dy mungesa të rëndësishme në prag të ndeshjeve të radhës, pasi Kai Havertz...

SPORT 25 Shtator13:32

**Shqipëria kërkon të thyejë mallkimin e 5 humbjeve radhazi, të shtunën sfidon Bjellorusinë**

Shqipëria nis këtë të shtunë aventurën në Ligën e Kombeve, me objektivin për të shmangur një seri histo...

SPORT 25 Shtator13:25

**Barcelona do të investojë mbi 500 milionë euro për "Camp Nou"-n e ri**

Barcelona po kërkon investitorë për një bond prej 300 milionë eurosh, që do të përdoret për të financuar rik...

SPORT 25 Shtator13:19

**Amorim zbulon rolin ideal të Rabiot: Mesfusha qendrore, zgjedhja më e mirë**

Adrien Rabiot nuk është tip që formalizohet lehtë. Kjo vjen pjesërisht sepse ai ka aftësi të gjera për të luajtur...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

**"Më quajti lopë kur isha shtatzënë"/ Pas videos...**

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

AKTUALITET 24 Shtator

**Sherr mes Lalës dhe Rexhajt: Meriton të rrihesh...**

Një përplasje e ashpër ka ndodhur në studion e "Opinion" mes analistit Albatros Rexhaj dhe gazetares Klodiana Lala. Debati u nd...

AKTUALITET 24 Shtator

**Prova që fundosi shefin e Policisë Shkencore, d...**

Një akt-ekspertimi për makinën "Land Rover Defender", i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërit...

INVESTIGIME 25 Shtator21:35

**Nga tritoli te kërcënimet me jetë/ Çfarë po ndodh me policin Altin Preka?**

Altin Preka, efektiv i Policisë së Shkodrës, rrëfen për "Piranjat" historinë e përplasjeve të tij me epror&e...

## video



**Institucionet në shërbim të krimit: Pse hesht kryeministri për skandalet?**





**Institucionet në shërbim të krimit: Pse hesht kryeministri për skandalet?**



**Nga tritoli te kërcënimet me jetë: Çfarë po ndodh me policin Altin Preka?**



**Porti i Durrësit po mbyllet, investimet në infrastrukturë vazhdojnë. Cili është justifikimi i APD?**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.